

Gjykatës Themelore në Prishtinë  
Departamentit për Çështje Administrative

**Paditës:** Partia Socialdemokrate (PSD), subjekt politik i regjistruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me datën 21 gusht 2000, me nr. të regjistrimit 104-0800, me adresë Rr. Bajram Kelmendi nr. 68, Prishtinë, e përfaqësuar nga Kryetari i saj z. Dardan Molliqaj, më tutje <**Paditësi**>

**E Paditura:** Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP), me adresë në Rr. Zejnel Salihu – Nr.22 (ish ndërtesa e Gjykatës Themelore)10000, Prishtinë, e përfaqësuar nga Komisionerja e saj, znj. Krenare Sogojeva Dermaku, më tutje <**E Paditura**>

**Data:** 18 prill 2023

## P A D I

**për anulimin e Vendimit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP), nr. 23/2023, i identifikuar sipas njësisë 04, me nr. të protokollit 204, dhe i nxjerrë me datën 05 prill 2023**

- për shkak se nuk janë aplikuar fare ose nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore -  
dhe

- për shkak se në procedurë, që i ka paraprirë aktit, nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike, apo nëse nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike -

### I. GJENDJA FAKTIKE

1. Në vitin 2015, partitë opozitare të Kuvendit të Kosovës, të përbëra nga Lëvizja Vetëvendosje, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, dhe Nisma Socialdemokrate kanë nisur një peticion kundër katër marrëveshjeve të nënshkruara nga Qeveria e Kosovës me Republikën e Serbisë me datën 25 gusht 2015. Përgjatë disa muajve, mbi dyqind mijë qytetarë janë nënshkruar në këtë peticion.
2. Mbështetja e dhënë në këtë peticion është materializuar përmes ofrimit të të dhënave personale në gjithsej gjashtë rubrika, e që kanë përfshirë: emrin dhe mbiemrin, komunën, nr. e letërnjoftimit, datën, nr. e telefonit dhe nënshkrimin. Këto të dhëna janë dhënë nga vetë qytetarët që janë nënshkruar në një dokument që ka qenë i titulluar “PETICION”.

Në të njëjtin ka ekzistuar hapësira që deri në pesëmbëdhjetë qytetarë të ofrojnë të dhënat e tyre.

3. Në këtë dokument është përcaktuar edhe qëllimi i tij përmes një teksti i cili, pas titullit “PETICION”, është si në vijim: *Ne, qytetarët e Republikës së Kosovës të nënshkruar në këtë peticion, i kundërshtojmë katër marrëveshjet e datës 25 gusht 2015 të nënshkruara me Serbinë, që lidhen me krijimin e Asociacionit/ Bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë, (2) barrikadën në Urën e Ibrit në Mitrovicë, (3) Kodin telefonik shtetëror dhe (4) marrëveshjen për energjinë, si dhe marrëveshjen për demarkacionin me Malin e Zi. Këto marrëveshje me Serbinë e ndajnë Kosovën në vija etnike duke krijuar një entitet të ri politik serb brenda Kosovës që rrezikon copëtimin e territorit, mosfunksionimin e shtetit, pengimin e zhvillimit ekonomik dhe çon drejt një bashkëqeverisje të Kosovës me shtetin e Serbisë, i cili nuk e njeh pavarësinë e Republikës së Kosovës. Edhe marrëveshja me Malin e Zi është brenda së njëjtës linjë që çon drejtë humbjes së territorit të Republikës së Kosovës. Këto marrëveshje nuk i përfaqësojnë interesat e qytetarëve të Kosovës dhe ato janë diskriminuese në baza etnike. Qytetarët e Kosovës nuk ia kanë dhënë asnjëherë mandatin Qeverisë së Kosovës që të pranoj marrëveshje të tilla. Rrjedhimisht : Ne qytetarët e Republikës së Kosovës të nënshkruar në këtë peticion, kërkojmë nga Qeveria e Republikë së Kosovës që të tërbeq menjëherë nënshkrimin nga katër marrëveshjet e datës 25 gusht 2015 të nënshkruar me Serbinë si dhe nga marrëveshja për demarkacion me Malin e Zi. Më pastaj ky tekst përfundon me një fjali: (Subjektet politike nismëtar të këtij peticioni janë: Lëvizja VETËVENDOSJE!, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe NISMA për Kosovën).*

**Provë:**

Një kopje standarde e këtij peticioni pa përmbajtje të të dhënave specifike personale.

4. Nënshkrimet e dhëna në këtë peticion më pastaj janë përdorur nga opozita e asaj kohe për të ushtruar presion publik në shërbim të kundërshtimit të këtyre marrëveshjeve. Përveç Qeverisë, ndaj të cilës i drejtohej ky peticion, i njëjti i është dorëzuar në kopje Kuvendit të Republikës së Kosovës, por edhe vetë Presidentes së Kosovës, atëkohë znj. Atifete Jahjaga. I njëjti ishte raportuar se do t'i dorëzohej edhe organizatave të ndryshme ndërkombëtare.
5. Në vitin 2018, një numër i madh i deputetëve dhe anëtarëve të strukturave udhëheqëse të Lëvizjes Vetëvendosje kishin dhënë dorëheqje nga kjo e fundit për të kaluar në Partinë Socialdemokrate.
6. Që nga kjo kohë, Paditësi në diskursin e vet politik qëndron në kundërshtim të këtyre marrëveshjeve, me theks të veçantë të marrëveshjes që lidhet me krijimin e

Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë. Në këtë drejtim, Padiësi ka organizuar protesta dhe aksione të ndryshme politike kundërshtuese.

7. Me datën 06 mars 2023, Padiësi organizon një aksion politik në Prishtinë, të cilin e titullon “205,000 NËNSHKRIME SHKELEN NGA KËMBA E KURTTIT”. Në këtë aksion, kopje të peticionit, të ngjitura me njëra tjetrën janë vendosur para hyrjes së ndërtesës së Qeverisë së Republikës së Kosovë. Padiësi këtë aksion politik e arsyeton para mediave sipas tekstin si në vijim: *Peticioni i shtrirë sot para shkallëve të Qeverisë është rruga mbi të cilën ka shkelur Kurti me dakordimin e tij në Bruksel. Mbi këtë rrugë eci dhe u ngrit. Nga po e njëjta do të rrëzohet, sepse vullneti i shprehur kundër Asociacionit (2015) nuk e duron gjatë mobimit. Ky kryeministër ka humbur legjitimitetin e tij politik; ai erdhi në pushtet që të mos pranojë Asociacionin, e bëri pikërisht të kundërtën. Dhe më shpejt se qeveritë e kaluara veproi. I dha tempo një procesi që ka destinacion Asociacionin. Paqja e përbërshme nuk paska qenë as qëllimi. Marrëveshja e dakorduar në mes të Kurtit dhe Vuçiqit është dëm i përbërshëm për shtetësinë dhe karakterin e saj unitar. Dobësimi i kufirit me Serbinë, heqja dorë nga njohja reciproke ndërmjet dy vendeve dhe pranimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe janë pjesët me të cilat Kurti, me të dyja këmbët e tij, ka shkelur mbi nënshtetësitë e 205,000 qytetarëve që nënshtetëruan peticionin kundër marrëveshjes së Asociacionit. Dhe së dyti, po të njëjtin vullnet që erdhi nga zgjedhjet e fundit parlamentare të 14 shkurtit 2021. Kjo marrëveshje është jashtëzakonisht e dëmshme sepse ka Asociacion e nuk ka njohje brenda. Prandaj duhet ta kundërshtojmë fuqishëm. Aktiviteti ynë do të vazhdojë. Protestat janë domosdoshmëri. Organizim është përgjigja e vetme.*

**Provë:**

Një fotografi që tregon shtrirjen e kopjeve të ngjitura të peticionit në aksionin e datës 06 mars 2023.

8. Në të njëjtën ditë, të gjitha fletat e këtij peticioni të vendosura para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës, menjëherë pas përfundimit të tij, janë larguar nga pjesëtarë të Policisë së Kosovës duke pamundësuar qasjen e kujdoqoftë mbi të njëjtat.
9. Me datën 10 mars 2023, përfaqësues të së Padiurës, sipas iniciativës së vet, e jo sipas ndonjë ankesë të veçantë të ndonjë subjekti që mund të këtë pretenduar cenim të të dhënave personale nga ky aksion politik, kanë vizituar zyrat e Padiësit, ku përfaqësues të këtij të fundit i kanë deklaruar se nuk kanë më kopje të këtij peticioni në posedim.
10. Me datën 05 prill 2023, e Padiura nxjerrë vendim që parasheh dy çështje me rëndësi – shqiptimin e një gjobe prej 20,000.00 € (njëzetmijë euro) ndaj Padiësit, si dhe urdhëron

Paditësin të shkatërroj të gjitha listat me të dhëna personale të grumbulluara me rastin e petitionit të vitit 2015.

**Provë:**

Vendimi i Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP), nr. 23/2023, i identifikuar sipas njësisë 04, me nr. të protokollit 204, dhe i nxjerrë me datën 05 prill 2023.

## II. BAZA LIGJORE

11. Vendimi që është objekti i kësaj padie përbën akt administrativ përfundimtar meqë ndaj të njëjtit nuk është lejuar ankesa, andaj Paditësi në përputhje me nenin 13, paragrafi 2 i Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative e fillon konfliktin administrativ ndaj tij.
12. Ky vendim lëngon nga zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore, përkatësisht i dispozitave përkatëse të Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Vendimi në çështjen kryesore të tij nuk zbaton drejtë dispozitat përkatëse të këtij ligji dhe për pasojë i cenon interesat ligjore të Paditësit. Thelbi i kësaj çështje konsiston në përcaktimin që e Paditura ia bën qëllimit të listave të petitionit.
13. E Paditura në faqen e katërt të vendimin të saj përcakton se *“Qëllimi i petitionit të zhvilluar ka qenë dërgimi i këtij peticioni tek organet kompetente për shqyrtimin e kësaj nisme, që nënkupton dërgimin në Kuvendin e Kosovës, që në kuptim të LMDhP-së përfundon edhe qëllimi i përpunimit të të dhënave.”*. E Paditura në vendimin e saj nuk e shqyrton më tutje vlerësimin e saj mbi qëllimin e petitionit, i cili përbën edhe çështjen më kryesore të vendimit, por edhe të kësaj padie, pra çka në fakt përbën qëllimin e petitionit të nënshkruar nga më shumë se dyqind mijë qytetarë.
14. Në këtë drejtim, qëllimi i petitionit mund të përcaktohet vetëm në bazë të tij, pra të vetë tekstit të petitionit, në fletat e të cilit qytetarët, kanë ofruar të dhënat e tyre personale. Në gjithë tekstin e petitionit spikat një fjali që më së lehti mund të përcaktojë qëllimin e tij dhe e njëjta lexon si *“Ne qytetarët e Republikës së Kosovës të nënshkruar në këtë peticion, kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të tërheq menjëherë nënshkrimin nga katër marrëveshjet e datës 25 gusht 2015 të nënshkruar me Serbinë si dhe nga marrëveshja për demarkacion me Malin e Zi”*. Pra, kjo fjali nga teksti i petitionit qartazi përcakton se qëllimi i këtij peticioni është kërkesa që qytetarët e nënshkruar në të i bëjnë Qeverisë së Kosovës drejt tërheqjes së nënshkrimit në

këto katër marrëveshje, e përfshirë këtu edhe marrëveshjen që lidhet me krijimin e Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë, e që për pasojë lidhet me aksionin e datës 06 mars 2023 të organizuar nga Paditësi.

15. Sikur ky peticion të kishte qenë i kushtëzuar nga norma imperative juridike që do përcaktonin përfundimin e qëllimit të tij me dorëzimin e të njëjtit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, konstatimi i të Paditurës do të ishte i saktë. Së këndejmi, p.sh. të tilla situata i parashih edhe Ligji nr. 04/-L-025 për Nisma Legjislative, ku në bazë të tij, qytetarët gëzojnë të drejtën e nismës për të propozuar ligje duke hartuar të njëjtat apo duke i propozuar Kuvendit hartimin e tyre. Përgjatë ushtrimit të kësaj të drejte, këto nisma i nënshtrohen respektimit të procedurave të veçanta që ndërlidhen me njoftimin paraprak të Kuvendit për këto nisma, kohën maksimale të mbledhjes së nënshkrimeve, përmbajtjen dhe verifikimin e listave, si dhe dërgimin pastaj në Kuvend të listave me nënshkrime.
16. Pra, në situatën që peticioni që është trajtuar nga vendimi që është objekt i kësaj padie të ishte realizuar në kuadër të ligjit të sipërshtuar apo edhe ndonjë ligji tjetër që precizojnë saktë veprimet që duhen ndërmarrë me këto lista, do të kishte kuptim vlerësimi i të Paditurës së qëllimi i peticionit është dërgimi i tij pranë organeve kompetente, përkatësisht Kuvendi i Kosovës. Mirëpo, në rastin konkret, kjo nuk është situata.
17. Peticioni nuk ka qenë i kushtëzuar të dërgohet në ndonjë institucion kompetent qoftë sipas tekstit të tij apo edhe sipas ndonjë norme juridike në fuqi. Për pasojë, vlerësimi i të Paditurës në vendimin e saj se qëllimi i peticionit qëndron i përfunduar meqë i njëjti i është dorëzuar organeve kompetente, përkatësisht Kuvendit të Kosovës përbën zbatim jo të drejtë të dispozitës ligjore të cilës i referohet, përkatësisht nenit 5, të Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
18. Kjo dispozitë ligjore parashih kriteret në bazë të së cilave mund të konsiderohet së të dhënat personale mund të përpunohen në mënyrë të ligjshme. Paragrafi 1 i kësaj dispozite përcakton se përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm vetëm nëse zbatohet, të paktën, njëri nga gjashtë kriteret e parapara aty. Dy ndër këto kriteret, të cilat janë me rëndësi për rastin konkret, përcaktohen në nënparagrafiët 1.1 dhe 1.5, ku parashihet se përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij për përpunimin e të dhënave të tij personale për një ose më shumë qëllime specifike, apo nëse përpunimi është i domosdoshëm për kryerjen e një detyre me interes publik.

19. Pra, nga perspektiva e nenit 5, përkatësisht nënparagrafëve 1.1 dhe 1.5 të Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është e qartë se përdorimi i listave të peticionit në shërbim të qëllimit që është paraparë në këto lista përbën përtej çdo hamendësimi përpunim të ligjshëm të të dhënave personale meqë aksioni i Paditësit si i përshkruar në pikën 7 të kësaj padie përbën përdorim të ligjshëm të atyre të dhënave meqë të njëjtat i përdorë mu për të njëjtin qëllim për të cilin ato janë ofruar. Për më tepër nuk duhet anashkaluar dimensionin e përmbushjes së një detyre publike që veprimi i Paditësit përbën në vetvete meqë marrëveshja në fjalë kundër së cilës janë dhënë këto nënshkrime vazhdon të jetë në fuqi dhe kjo falë vullnetit të shprehur nga Qeveria aktuale e Kosovës pa asnjë dallim esencial nga Qeveria kur këto nënshkrime janë dhënë.
20. Tutje, duhet theksuar se asnjë subjekt i këtyre të dhënave personale nuk ka paraqitur ankesë pranë të Paditurës dhe gjithashtu nuk mund të argumentohet se të dhënat personale e subjekteve të peticionit janë publike meqë qasja në to nga ana e publikut është e absolutisht pamundshme.
21. Për më tepër, duke qenë se e Paditura ka qenë në dijeni se Paditësi nuk ka poseduar më lista të peticionit dhe kur merren parasysh alternativat e masave të inspektimit sipas nenit 71 të Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, masa e gjobës është qartazi në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit të paraparë me nenin 5 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative meqë qëllimin e mbrojtjes së të dhënave personale e Paditura ka mundur ta arrijë me ndonjë masë më të butë kur kihet parasysh se Paditësit asnjëherë nuk i është tërhequr asnjë vërejtje nga e Paditura meqë në të kaluarën Paditësi ka organizuar aksione të ngjashme në lidhje me këtë peticion.
22. Andaj, është e qartë që vendimi që është objekt i kësaj padie, qëndron në kundërshtim me parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit të parapara me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative për ashtu edhe siç është argumentuar më lart, e me theks të vecantë për atë se e Paditura nuk e zbaton drejtë nenin 5 të Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, zbatimin e gabuar të së cilës dispozitë ligjore ka krijuar edhe bazën ligjore për vendimin që ka cenuar interesat e Paditësit dhe që përbën objektin e kësaj padie.

### III. PADITËSI KËRKON SHTYRJEN E EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT

23. Pagesa e gjobës prej 20,000.00 € (njëzetmijë euro) do t'i sillte dëm Paditësit që vështirë do të riparohet. Paditësi është subjekt politik jashtëparlamentar dhe si i tillë nuk gëzon të

drejtën e marrjes së mbështetjes financiare sikurse siç është rasti me subjektet politike që përfaqësohen në Kuvendin e Kosovës, të cilat marrin mbështetje financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike Parlamentare që menaxhohet nga Komisioni Qendror Zgjedhor.

24. Padiësi është subjekt politik shumë aktiv në skenën politike të Kosovës. Aktiviteti i tij vërehet në aksione të shumta politike publike dhe paraqitje të shumta mediale.
25. Padiësi mbështetjen e aktiviteteve të veta e realizon nga kontributet personale të qytetarëve që i transferohen në xhironlogarinë e tij bankare. Është e vështirë të përcaktohet një konstante e mbështetjes financiare për një subjekt politik sikurse Padiësi meqë e gjithë kjo varet nga shumë faktorë, mirëpo për t'i ofruar Gjykatës një pasqyrë të më të qartë të kësaj mbështetjeje financiare, xhironlogaria e Padiësit nga data 01 janar 2023 deri me datën 05 prill 2023 është kredituar me gjithsej 6,950.00 Euro dhe mjete të pa harxhuara kanë ngelur vetëm 2,450.93 Euro.

**Provë:**

Qarkullimi i xhironlogarisë së Partisë Socialdemokrate nr. 1501090001041368 pranë Raiffeisen Bank për periudhën 01.01.2023 - 05.04.2023.

26. Padiësi nga të hyrat që i merr nga kontributet i mbulon shpenzimet e veta operationale që përgjithësisht ndërliidhen me pagesa të pagave, qirasë për hapësirat e punës, dhe shpenzimeve tjera që ndërliidhet me aktivitetet e ndryshme që i realizon. Në vitin 2022, Padiësi ka pasur të hyra prej 49,606.00 Eurove dhe shpenzime prej 45,557.26. Ndërsa, në vitin 2021, të hyrat e tij kanë qenë 29,507.63 Euro, ndërsa shpenzimet 28,679.21 Euro.

**Provë:**

Raportet Vjetore Financiare të Partisë Socialdemokrate për vitin 2023 dhe 2022.

27. Nga pasqyrat e mësipërme financiare shihet qartë se ekzekutimi i vendimit që është objekt i kësaj padie e përbën një barrë të papërballueshme financiare për Padiësin duke e detyruar të njëjtin të pezullojë aktivitetin e tij e për pasojë duke i krijuar një dëm që vështirë mund të riparohet në të ardhmen. Për një subjekt politik sikurse Padiësi, dëmi që do i shkaktohej shtrihet në dy rrafshje: 1. largimin e resurseve njerëzore të tij dhe cenimin e mirëqenies së tyre dhe familjeve të tyre, dhe 2. mbylljen e hapësirave të punës dhe pamundësinë për të



mbështetur aspektet logjistike të aktiviteteve. Pagesa e kësaj gjobe, këtë dëm do e shkaktonte për një afat të pacaktuar marrë parasysh që pezullimi i aktivitetit vështirë se mund të nxis kontribute të qytetarëve duke e vendosur kështu Paditësin në një pozitë të rënduar nga e cila vështirë se do mund të dilte. Andaj, është e qartë se ekzekutimi i këtij vendimi do shkaktonte një dëm që vështirë do mund të riparohej në të ardhmen.

28. Në anën tjetër, kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të këtij vendimi në mënyrë kumulative përmbushë edhe dy kriteret tjera të Nenit 22 të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative. Mospagesa e kësaj gjobe në këtë kohë në asnjë mënyrë nuk mund të argumentohet se cenon interesin publik meqë për arkën shtetërore shuma prej 20,000.00 Euro është e papërfillshme financiarisht. Gjithashtu, shtyrja e këtij vendimi në asnjë mënyrë nuk i shkaktton dëm të Paditurës apo eventualisht ndonjë pale të interesuar.
29. Andaj, duke u mbështetur në Paragrafin 2 dhe 3, të Nenit 22 të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, Paditësi i propozon Gjykatës Themelore në Prishtinë, që brenda afatit të paraparë ligjor të nxjerrë këtë:

### AKTVENDIM

- I. **APROVOHET** kërkesa për shtyrje të Vendimit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP), nr. 23/2023, i identifikuar sipas njësisë 04, me nr. të protokollit 204, dhe i nxjerrë me datën 05 prill 2023.
- II. **SHTYHET** ekzekutimi i Vendimit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP), nr. 23/2023, i identifikuar sipas njësisë 04, me nr. të protokollit 204, dhe i nxjerrë me datën 05 prill 2023.
30. Andaj, duke u bazuar në elaboratin e mësipërm ku është precizuar se në objektin e kësaj padie se nuk janë aplikuar fare ose nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore, e duke u bazuar në provat e kësaj Padie dhe duke u mbështetur në normat e aplikueshme ligjore, Paditësi i propozon Gjykatës që pas shqyrtimit të të gjitha provave veç e veç dhe të gjithave së bashku, të merr këtë:

### AKGJYKIM

- I. **APROVOHET** si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e Paditësit Partia Socialdemokrate (PSD), subjekt politik i regjistruar pranë Komisionit Qendror të





PSD  
E MAJTA  
DEMOKRATIKE

Zgjedhjeve, me datën 21 gusht 2000, me nr. të regjistrimit 104-0800, me adresë Rr. Bajram Kelmendi nr. 68, Prishtinë, e përfaqësuar nga Kryetari i saj z. Dardan Molliqaj.

- II. ANULOHET** Vendimi i Vendimit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP), nr. 23/2023, i identifikuar sipas njësisë 04, me nr. të protokollit 204, dhe i nxjerrë me datën 05 prill 2023.

## **PADITËSI**

---

Dardan Molliqaj  
Kryetar i Partisë Socialdemokrate

në Prishtinë, me 18 prill 2023

## **IV. LISTA E PROVAVE**

1. Kopjet e dokumenteve të regjistrimit/identifikimit;
2. Një kopje standarde e këtij peticioni pa përmbajtje të të dhënave specifike personale.
3. Një fotografi që tregon shtrirjen e kopjeve të ngjitura të peticionit në aksionin e datës 06 mars 2023.
4. Vendimi i Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP), nr. 23/2023, i identifikuar sipas njësisë 04, me nr. të protokollit 204, dhe i nxjerrë me datën 05 prill 2023.
5. Qarkullimi i xhirollogarisë së Partisë Socialdemokrate nr. 1501090001041368 pranë Raiffeisen Bank për periudhën 01.01.2023 - 05.04.2023.
6. Raportet Vjetore Financiare të Partisë Socialdemokrate për vitin 2023 dhe 2022.